



19.08.2019

01.Nr.4/19-26732/19

Në mbështetje të nenit 13 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-40- për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 paragrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 07/2016 për Procedurat e Shitjes së Mallrave me Ankand Publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Vendim, themelohet komisioni për zhvillimin e procedurave të ankandit publik me mandat dy vjeçar nga data e nënshkrimit me këtë përbërje:
 - a. Fadil Guri - Anëtar i përhershëm;
 - b. Arsim Zenuni - Anëtar i përhershëm;
 - c. Festim Neziraj - Anëtar vetëm për procedurën e shitjes së veturave.
2. Detyrat e komisionit si në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - a. Përgatitë ftesën për ankand publik sipas Shtojcës nr.1 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 07/2016 për Procedurat e Shitjes së Mallrave me Ankand Publik;
 - b. Përgatit listën e mallrave të cilat do të shiten në ankand dhe çmimin fillestar të tyre, të përgatitur nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
 - c. Përcakton datën, afatin kohor dhe vendin e prezantimit të mallrave para shpalljes së ankandit;
 - d. Pranon ofertat nga ofertuesit. Me rastin e pranimin të ofertave duhet të jenë prezent së paku 2 (dy) anëtarë të Komisionit. Ofertat duhet të ruhen në vende të sigurta brenda institucionit dhe
 - e. I ofron Komisionit vlerësues të gjithë materialin e pranuar nga ofertuesi, përfshirë listën e mallrave me çmimin fillestar, si dhe listën e ofertuesve ashtu siç parashihet në Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 07/2016 për Procedurat e Shitjes së Mallrave me Ankand Publik.
3. Pas përfundimit të procesit, komisioni është i obliguar që të njoftoj me raport me shkrim Kryetarin e Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

Anëtarët e Komisionit;

Arkivi.

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi

